



Prishtinë, 24 korrik 2009
Kodi i ZRRE-së: V_202_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenit 6 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
4. Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 21.07.2009 për aprovimin e dokumentit **“Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013”**

në seancën e mbajtur më 23.07.2009 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

Aprovohet dokumenti **“Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013”** si në Shtojcën 1 të këtij vendimi.

ARSYETIM

1. ZRRE me datë 21.07.2009 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit **“Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013”** të KOSTT SH.A. Dokumenti ka qenë në shqyrtim dhe përpunim nga KOSTT një kohë të gjatë, duke përfshirë komentet e shumta nga ZRrE, dhe së fundit ka marrë formën që kërkohet për një dokument të një rëndësie të lartë. Prandaj ZRrE pas analizimit dhe vlerësimit të dokumentit, dhe kërkesës së KOSTT-it ka parë të arsyeshme që **të aprovoj** dokumentin si në shtojcën 1 të këtij vendimi.
2. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Vendimit i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Shtojca 1 - **“Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013”**
2. Shtojca - Kërkesa e KOSTT-it;

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

